

## NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.5295/17

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i përgjithshëm**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli, me sekretaren juridike Sanije Trashupa, në çështjen penale, kundër të pandehurit Sh.T., për shkak të veprës penale Posedimi i paautoizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par. 2 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4173/2017, të dt. 20.11.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhërit ndëshkimorë PP.II.nr.4173/2017, të dt. 20.11.2017, më dt. **09.01.2018**, jashtë seancës, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 4173/2017, të dt .20.11.2017 dhe kjo gjykatë jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

**I pandehuri: Sh.T.**, nga i ati M. dhe e ëma S.- e vajzërisë K., i lindur me ..., në P., me vendbanim në rr. "B.B." pa numër, në P., me profesion t., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

#### S e p s e:

Pa autorizim ka poseduar substanca narkotike, ashtu që me datën 07.07.2017, rreth orës 22:00, në rrugën "M.K." në P., gjatë një kontrolli të ushtruar nga Policia e Kosovës, tek i pandehuri Sh.T. është gjetur dhe sekuestruar një qese me substanca narkotike, me ngjyrë të gjelbër, ku pas ekzaminimit është konstatuar se në bazë të karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike, substanca narkotike është e llojit Marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 0.78 gram.

-me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautoizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par. 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK, si dhe neneve 365 e 495, të KPP të Republikës së Kosovës, të pandehurit i shqipton:

### DËNIM ME GJOBË

**I pandehuri Sh.T.** dënohet në shumë prej **200 (dyqind euro) €**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet) € të gjobës.

Konfiskohet substancë narkotike e llojit Marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 0.78 gram.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumën prej **20.00 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.4173/2017, të dt.20.11.2017 ka akuzuar të pandehurin **Sh.T.**, për shkak të veprës penale Posedimi i paautoizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par. 2 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPP të Republikës së Kosovës, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPP i RK, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë, pas vlerësimit me shumë kujdes të gjitha provave materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: Kallëzimi penal i Policisë së Kosovës 2017-DHTN-362 i datës 13.07.2017, procesverbali mbi intervistimin e të pandehurit Sh.T. i dt.07.07.2017, Raporti i policisë i dt. 07.07.2017, Vërtetimi mbi marrjen e përkohshme i dt. 07.07.2017 me fotodokumentacion ngashkresta e lëndës,Raporti i ekspertimit AKF/2017-2499/2017-2255 i dt. 27.10.2017 dhe nga shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata konstaton se i pandehuri Sh.T., është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Posedimi i paautoizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par. 2 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha elementet e kësaj vepre penale.

Me rastin e shqyrtimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 74 të KPK-së.

Vendimi për konfiskimin e substancës narkotike është marrë në bazë të dispozitës së nenit 275 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësorë, është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I  
PËRGJITHSHËM  
P.nr.5295/17, i dt. 09.01.2018**

Sekretarja juridike,  
Sanije Trashupa

Gjyqtari,

Rrustem Begolli

**KËSHILLË JURIDIKE:**

I pandehuri ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimorë, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.